

MARRËVESHJE E AUTORITETEVE KOMPETENTE

NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE ATYRE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Më 26 shkurt 2015, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës nënshkruan marrëveshje ndërqeveritare ("IGA") me titull, "Marrëveshje midis Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës e Kosovës për përmirësimin e pajtueshmërisë së rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve të FATCA". IGA kërkon, në veçanti, shkëmbimin automatik të informacionit të caktuar në lidhje me Llogaritë e SHBA-së të cilat i nënshtrohen raportimit.

Neni 3(6) i IGA-së parasheh që Autoritetet Kompetente të Shteteve të Bashkuara dhe ato të Kosovës ("Autoritetet Kompetente") "do të nënshkruajnë një marrëveshje ose aranzhim me procedurën për arritjen e një marrëveshjeje të përbashkët që është përshkruar në nenin 8" të IGA-s, në mënyrë që të vendosen dhe të përshkruhen rregullat dhe procedurat e nevojshme për zbatimin e dispozitave të caktuara në IGA. Neni 8 i IGA-së lejon Autoritetet Kompetente të adresojnë çështje të tjera në lidhje me zbatimin e IGA-së. Në përputhje me IGA-në dhe pas konsultimeve ndërmjet Autoriteteve Kompetente, Autoritetet Kompetente kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme ("Marrëveshja").

Shprehjet e përdorura si në këtë Marrëveshje ashtu edhe në IGA kanë të njëjtin kuptim si në IGA, përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje. Referencat në paragrafë konsiderohen referenca në paragrafët e kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse specifikohet ndryshe. Përveç nëse parashikohet ndryshe në IGA, çdo referencë në Rregulloret e Thesarit të SHBA-së konsiderohet referencë në rregulloret përkatëse në fuqi në kohën e aplikimit. Referencat në Publikimet e Shërbimit të Hyrave të Brendshme ("IRS") përfshijnë versionet e përditësuara. Të gjitha referencat në ditët që përmbajnë periudha kohore për përfundimin e veprimeve u referohen ditëve kalendarike dhe jo ditëve të punës. Sidoqoftë, nëse periudha e tillë përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare shtetërore, ajo do të trajtohet si e mbaruar në ditën tjetër kalendarike që nuk është e shtunë, e diel ose festë zyrtare shtetërore.

Paragrafi 1

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI

- 1.1 Siç parashihet në nenin 3(6) të IGA-s, kjo Marrëveshje përcakton procedurat për shkëmbimin automatik të detyrimeve të informacionit, siç është përcaktuar në nenin 2 të IGA-s, dhe për shkëmbimin e informatave për të cilat raportohet sipas nenit 4(1)(b) të IGA-s. Informatat që do të shkëmbehen në përputhje me nenet 2 dhe 4(1)(b) të IGA-s përfshijnë informatat e dhëna:

- 1.1.1 nga një Institucion Financiar Raportues i Kosovës,
- 1.1.2 nga ose në emër të secilit prej Institucioneve Financiare Jo Raportuese të Kosovës që do të trajtoheshin si FFI (Institucion Financiar i Huaj) sipas Shtojcës II të IGA-së për qëllimet e seksionit 1471 të Kodit të të Hyrave të Brendshme të SHBA-së (“Paragrafi 1.1. 2 Institucioni Financiar”):
- institucion financiar me bazë lokale të klientëve, siç përshkruhet në Seksionin III(A) të Shtojcës II të IGA-së;
 - administrues i besuar - Trusti i dokumentuar (Trustee-Documented Trust), siç përshkruhet në Seksionin IV(A) të Shtojcës II të IGA-së;
 - subjektet investues të sponsorizuara, siç përshkruhet në Seksionin IV(B)(1) të Shtojcës II të IGA-së;
 - kompani e huaj e kontrolluar dhe e sponsorizuar, siç përshkruhet në Seksionin IV(B)(2) të Shtojcës II të IGA-së;
 - kompani investuese e sponsorizuar dhe me numër të vogël të aksionarëve me interes kontrollues (Closely Held Investment Vehicle), siç përshkruhet në Seksionin IV(C) të Shtojcës II të IGA-së; ose
 - kompani kolektive investuese që përshkruhet në Seksionin IV(F)(4) të Shtojcës II të IGA-së.
- 1.2 Institucion Financiar i Kosovës që përndryshe do të kualifikohej si Institucioni Financiar sipas paragrafit 1.1.2, dhe rrjedhimisht si Institucion Financiar Jo Raportues sipas nenit 1(1)(o) të IGA-së, por i cili nuk plotëson një ose më shumë nga kërkesat e zbatueshme në Shtojcën II ose Rregulloret përkatëse të Thesarit të SHBA-së është Institucion Financiar Raportues i Kosovës sipas nenit 1(1)(n) të IGA-së.
- 1.3 Siç parashihet në nenin 3(6) të IGA-së, kjo Marrëveshje përcakton rregulla dhe procedura siç mund të jenë të nevojshme për zbatimin e nenit 5 të IGA-së.
- 1.4 Siç lejohet nga neni 8 i IGA-së, kjo Marrëveshje adreson çështje të tjera në lidhje me zbatimin e IGA-së, duke përfshirë: regjistrimin, konfidencialitetin dhe mbrojtjet e tjera, kostot, konsultimin dhe modifikimin, si dhe publikimin e kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 2

REGJISTRIMI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE TË KOSOVËS

- 2.1 E përgjithshme: Autoritetet Kompetente theksojnë që, sipas nenit 4(1)(c) dhe Shtojcës II të IGA-së, Institucioni Financiar Raportues i Kosovës ose Institucioni Financiar sipas paragrafit 1.1.2 do të trajtohej sikur të jetë në përputhje me

seksionin 1471 të Kodit të të Hyrave të Brendshme të SHBA-së dhe nuk do t'i nënshtrohej mbajtjes në burim sipas atij seksioni nëse Institucioni Financiar Raportues i Kosovës ose Institucioni Financiar sipas paragrafit 1.1.2 (ose, kur aplikohet, sponsori ose administruesi i besuar i tij), midis kërkesave të tjera, përputhet me kërkesat e aplikueshme për regjistrim që gjenden në faqen e internetit të FATCA-s për regjistrim. Autoritetet Kompetente gjithashtu theksojnë se IRS synon të lëshojë numër global identifikues të ndërmjetëm ("GIIN") për secilin Institucion Financiar Raportues të Kosovës dhe Institucion Financiar sipas paragrafit 1.1.2 që plotëson me sukses kërkesat e regjistrimit në FATCA.

- 2.2 Përfshirja e Institucioneve Financiare të Kosovës në listën IRF FFI: IRS synon të përfshijë në "listën IRS FFI" (siç përcaktohet në seksionin 1.1471-1(b)(73) të Rregullores së Thesarit të SHBA-së) emrin dhe GIIN-in e secilit Institucion Financiar të Kosovës të cilit i është lëshuar një GIIN nga Sistemi i Regjistrimit i FATCA-s. Megjithatë, në bazë të nenit 5(3)(b) të IGA-s dhe paragrafit 4.3.2.2, Institucioni Financiar i regjistruar i Kosovës do të hiqej nga lista IRS FFI nëse problemi i mospërputhjes së konsiderueshme nuk zgjidhet brenda periudhës 18-mujore.
- 2.3 Shkëmbimi i Informatave të Regjistrimit: Autoriteti Kompetent i SHBA-së synon t'ia ofrojë Autoritetit Kompetent të Kosovës çdo vit informatat e nevojshme për ta identifikuar çdo Institucion Financiar të regjistruar të Kosovës të përfshirë në listën IRS FFI.

Paragrafi 3

KOHA DHE MËNYRA E SHKËMBIMIT TË INFORMATAVE

- 3.1 Shkëmbimi automatik brenda nëntë muajsh: Në përputhje me nenet 3(5) dhe 3(6) të IGA-së, Autoriteti Kompetent i Kosovës synon t'i shkëmbejë automatikisht me Autoritetin Kompetent të SHBA-së informatat e përshkruara në nenet 2 dhe 4(1)(b) të IGA-së brenda nëntë (9) muajve pas përfundimit të vitit kalendarik me të cilin kanë të bëjnë informatat.
- 3.2 Formati:
- 3.2.1 Informatat e përshkruara në nenet 2(2) dhe 4(1)(b) të IGA-së: Skema FATCA, siç pasqyrohet në Udhëzuesin e Përdoruesit të Skemës FATCA XML (Publikimi IRS 5124), dhe Skemës FATCA Metadata XML, siç pasqyrohet në Udhëzuesin e Përdoruesit të Skemës FATCA Metadata XML (Publikimi IRS 5188), postuar në <http://www.irs.gov/FATCA> ("IRS.gov") kanë për qëllim të përdoren si formati për shkëmbimin e informatave të përshkruara në nenet 2(2) dhe 4(1)(b) të IGA-së. Udhëzuesi i Përdoruesit të Skemës FATCA XML (Publikimi IRS 5124) dhe Udhëzuesi i Përdoruesit të Skemës FATCA Metadata XML (Publikimi IRS 5188) përshkruajnë strukturën e skemës dhe përfshijnë fjalorë të të dhënave me përmbledhje të elementeve përkatëse të të dhënave.

- 3.2.2 Njoftimet: Autoriteti Kompetent i SHBA-së synon t'i përdorë skemat e përshkruara në Udhëzuesin e Përdoruesit të Skemës FATCA XML (Publikimi IRS 5124), Udhëzuesin e Përdoruesit të FATCA Metadata XML (Publikimi IRS 5188), dhe Udhëzuesin e Përdoruesit për Skemën XML të Njoftimeve në Kuadër të Raporteve FATCA (Publikimi IRS 5216) të postuara në IRS.gov si formati për dhënien e njoftimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje.
- 3.2.3 Ndryshimet e Skemës: IRS synon të postojë çdo ndryshim në skemat e zbatueshme për vitet e caktuara kalendarike në IRS.gov sa më parë që të jetë e mundur. Kur është e mundur, IRS synon të sigurojë njoftime për ndryshime të tilla para postimit. Autoritetet Kompetente presin të ketë proces bashkëpunimi në lidhje me ndryshimet e skemës.

3.3 Transmetimi i Informacionit:

- 3.3.1 Metoda: Autoritetet kompetente synojnë të përdorin Shërbimin Ndërkombëtar të Shkëmbimit të të Dhënave ("IDES"), siç pasqyrohet në Udhëzuesin e Përdoruesit FATCA IDES (Publikimi IRS 5190) dhe Udhëzuesin e Përdoruesve të Skemës FATCA Metadata XML (Publikimi IRS 5188) i postuar në IRS.gov, për të gjitha llojet e shkëmbimit të informacionit, përfshirë njoftimet e përshkruara në Paragrafin 4.3, në përputhje me IGA.
- 3.3.1.1 Përdorimi i Ruterit Rajonal për Transmetim: Autoriteti Kompetent i Kosovës mund të zgjedhë të përdorë ruter rajonal (p.sh. "Speed 2" të Bashkimit Evropian për të transmetuar informacione dhe për të shkarkuar informacione nga IDES, ku Autoriteti Kompetent i SHBA ka aprovuar me shkrim atë ruter rajonal sa i përket pajtueshmërisë me standardet e specifikuar, përfshirë protokollet e enkriptimit dhe transmetimit në internet. Këto zgjedhje duhet të bëhen me shkrim dhe t'i dorëzohen Autoritetit Amerikan Kompetent përpara transmetimit të informacionit përmes ruterit rajonal në IDES ose të shkarkoni informacione nga IDES përmes ruterit rajonal.
- 3.3.1.2 Përdorimi i IDES si Mjet për Mbledhjen e të Dhënave: Autoriteti Kompetent i Kosovës mund të zgjedhë të përdorë IDES si mjet për mbledhjen e të dhënave të Modelit 1 Opsioni 2 ("M1O2") për shkëmbimin e informacionit të tij në përputhje me IGA. Procedurat dhe metodologjia e përdorimit të IDES në këtë mënyrë përshkruhen më hollësisht në Udhëzuesin e Përdoruesit FATCA IDES (Publikimi IRS 5190). Zgjedhja e M1O2 duhet të bëhen me shkrim dhe t'i dorëzohet Autoritetit Kompetent të SHBA-së para ngarkimit ose shkarkimit të informacionit në ose nga IDES nga ana e Institucioneve Financiare Raportuese të Kosovës ose nga ose në emër të Institucionit Financiar në kuadër të Paragrafit 1.1.2.
- 3.3.1.3 Konsistenca: Autoritetet Kompetente synojnë që zgjedhjet e përshkruara në Paragrafin 3.3.1.1 ose 3.3.1.2 të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha informacionet e ngarkuar ose të shkarkuar nga koha e zgjedhjes, përveç nëse zgjedhja e

tillë revokohet në mënyrën e duhur në përputhje me paragrafin 3.3.1.4.

- 3.3.1.4 Revokimi i zgjedhjes: Autoriteti Kompetent i Kosovës mund të revokojë zgjedhjen e përshkruar në Paragrafin 3.3.1.1 ose 3.3.1.2 pas konsultimit dhe njoftimit me shkrim të Autoritetit Kombëtar të SHBA-së.
- 3.3.2 Shkëmbimi i Informacionit: Informacioni i përshkruar në nenet 2(2) dhe 4(1) (b) të IGA-së do të konsiderohej i shkëmbyer në kohën e marrjes së specifikuar në Paragrafin 3.3.4. Shihni Paragrafin 5.2 në lidhje me përgjegjësinë e çdo Autoriteti Kompetent për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjeve të tjera në lidhje me informacionin e shkëmbyer.
- 3.3.3 Komentet dhe Konsultimi: Autoritetet Kompetente e kuptojnë se komentet në lidhje me cilësinë e të dhënave dhe përdorueshmërinë janë element i rëndësishëm i procesit të shkëmbimit dhe ata mund të konsultohen me njëri-tjetrin siç parashikohet në Paragrafin 7.2 lidhur me gabimet e të dhënave ose problemet e transmetimit të adresuara në mënyrë jo adekuate përmes proceseve standarde të njoftimit mbi IDES.
- 3.3.4 Koha e Marrjes: Përveç në rastet si vijon, informacioni i transmetuar përmes IDES nga Autoriteti Kompetent i Kosovës do të konsiderohej i ofruar dhe i marrë nga Autoriteti Kompetent i SHBA-së në datën kur informacioni ngarkohet me sukses në IDES. Përveç në rastet si vijon, informacioni i transmetuar nga Autoriteti Kompetent i SHBA-së përmes IDES do të konsiderohej i dhënë dhe i marrë nga Autoriteti Kompetent i Kosovës në datën kur informacioni është në dispozicion për shkarkim nga IDES.
- 3.3.4.1 Ruteri Rajonal: Nëse Autoriteti Kompetent i Kosovës zgjedh përdorimin e Ruterit Rajonal për transmetimin e informacionit përmes IDES, informacionin të cilin e transmeton Ruteri Rajonal do të konsiderohej i ofruar dhe i marrë nga Autoriteti Kompetent i SHBA-së në datën kur ngarkohet me sukses nga ruteri në IDES, dhe informacioni i transmetuar nga Autoriteti Kompetent i SHBA do të konsiderohet i ofruar dhe i marrë nga Autoriteti Kompetent i Kosovës në datën kur është në dispozicion për ta shkarkuar në ruter nga IDES.
- 3.3.4.2 Mjeti për Mbledhjen e të Dhënave M1O2: Nëse Autoriteti Kompetent i Kosovës zgjedh të përdorë IDES si Mjet për Mbledhjen e të Dhënave M1O2, informacioni do të konsiderohet i dhënë dhe i marrë nga Autoriteti Kompetent i SHBA në datën kur Autoriteti Kompetent i Kosovës miraton dhe për këtë arsye lëshon informacionin në IDES për Autoritetin Kompetent të SHBA dhe informacioni i transmetuar nga Autoriteti Kompetent i SHBA do të konsiderohet i dhënë dhe i marrë nga Autoriteti Kompetent i Kosovës në datën kur është në dispozicion për shkarkim nga

IDES. Shih Udhëzuesin e Përdorimit FATCA IDES (Publikimi 5190 IRS).

- 3.4 Njoftimi për Suksesin ose Dështimin e Përpunimit të Dosjeve:
- 3.4.1. Njoftimi për Suksesin e Përpunimit të Dosjeve: Brenda 15 ditëve nga marrja me sukses e dosjes që përmban informacionin e përshkruar në nenet 2(2) dhe 4(1) b) të IGA në kohën dhe mënyrën e përshkruar në nenin 3(5) të IGA dhe në Paragrafin 3, Autoriteti Kompetent i SHBA-së duhet të sigurojë njoftimin për marrjen e tillë të suksesshme pranë Autoritetit Kompetent të Kosovës. Autoriteti Kompetent i SHBA pret që të gjenerojë njoftim të tillë automatikisht përmes Modelit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Pajtueshmërisë (“ICMM”) dhe ta transmetojë atë përmes IDES. Njoftimi nuk ka nevojë të paraqesë pikëpamjen e Autoritetit Kombëtar të SHBA në lidhje me përshtatshmërinë e informacionit të marrë ose nëse Autoriteti Kompetent i SHBA beson se Autoriteti Kompetent i Kosovës duhet të marrë masa në përputhje me nenin 5 të IGA për të marrë informacion të korrigjuar ose të plotë.
- 3.4.2. Njoftimi për Dështimin e Përpunimit të Dosjeve: Brenda 15 ditëve nga marrja e dosjes që përmban informacione që nuk mund të përpunohen, Autoriteti Kompetent i SHBA-së duhet të sigurojë njoftimin për këtë dështim të përpunimit tek Autoriteti Kompetent i Kosovës. Autoriteti kompetent i SHBA pret që të gjenerojë njoftimin e tillë automatikisht përmes ICMM dhe ta transmetojë atë përmes IDES.
- 3.4.3 ICMM: Përshkrimi i informacionit shtesë dhe ICMM, duke përfshirë (i) Manualin e Përdoruesit për Njoftimet e ICMM në kuadër të Raporteve FATCA (IRS Publikimi 5189), dhe (ii) Manualin e Përdoruesit për Skemë XML të njoftimeve në kuadër të Raporteve FATCA, (IRS Publikimi 5216), mund të gjenden në IRS.gov.
- 3.5 Transliterimi: Çdo informacion që Autoriteti Kompetent i Kosovës shkëmben dhe që raportohet në alfabetin vendor jo-latin ose shkrimet që pritet të transliterohen në përputhje me procedurat e brendshme të Kosovës ose rregullave të përafruara me standardet ndërkombëtare për transliterim (për shembull siç specifikohet në ISO 8859) në alfabetin latin. Autoriteti Kompetent i Kosovës mund të dërgojë të dhëna përcaktuese (p.sh., emrin ose adresën) si në alfabetin ose shkrimin e saj vendor, si dhe veçmas në alfabetin latin, brenda secilit regjistrim të llogarisë, nëse zgjedh të bëj diçka të tillë. Autoriteti Kompetent i Kosovës gjithashtu duhet të jetë i përgatitur të transliterojë informacionin që merr nga Autoriteti Kompetent i SHBA-së nga alfabeti Latin në cilindo alfabet vendor jo-latin, që ai përdor ose pranon.

Paragrafi 4

RREGULLIMI DHE ZBATIMI

- 4.1 Në Përgjithësi: Autoriteti Kompetent i Kosovës duhet të përpiqet të sigurojë që të gjitha informacionet e specifikuara në nenet 2(2) dhe 4(1)(b) të IGA-së janë

identifikuar dhe raportuar nga Institucionet Financiare Raportuese të Kosovës dhe nga ose në emër të Institucioneve Financiare të Paragrafit 1.1.2 tek Autoriteti Kompetent i Kosovës, në mënyrë që informacioni i tillë të jetë i disponueshëm për t'u shkëmbyer me Autoritetin Kompetent Amerikan në kohën dhe mënyrën e përkthuar në nenin 3(5) të IGA-së dhe në Paragrafin 3.

4.2 Kategoritë e mospërputhshmërisë: Mospërputhshmëria me IGA-në mund të jetë e karakterit administrativ ose mund të jetë e vogël, apo mund të jetë edhe e konsiderueshme.

4.2.1 Mospërputhshmëri e Konsiderueshme: Sipas nenit 5 (3) të IGA-së, Autoriteti Kompetent i SHBA-së ka diskrecionin të konstatoj nëse ka mospërputhshmëri të konsiderueshme me detyrimet për marrjen dhe shkëmbimin e informacioneve të përkthura në nenin 2(2) dhe 4(1)(b) të IGA-së në lidhje me Institucionin Financiar Raportues të Kosovës. Autoriteti Kompetent i SHBA-ve gjithashtu ka diskrecion të konstatoj mospërputhshmërinë e konsiderueshme bazuar në dështimin (mosarritjen) për të përmbushur me kohë kujdesin e duhur, raportimin, mbajtjen në burim dhe obligime të tjera në lidhje me Institucionin Financiar Raportues të Kosovës. Autoriteti Kompetent i SHBA-ve mund të konstatojë që disa dështime përbëjnë mospërputhshmëri të konsiderueshme në lidhje me Institucionin Financiar Raportues të Kosovës, pavarësisht nëse dështimi i atribuohet Autoritetit Kompetent të Kosovës apo Institucionit Financiar Raportues të Kosovës. Shembuj të mospërputhshmërisë së konsiderueshme janë dhënë në Paragrafët 4.2.1.1 deri në 4.2.1.3.

4.2.1.1 Dështimet e raportimit: Autoriteti Kompetent i SHBA-ve mund të konstatoj mospërputhshmëri të konsiderueshme duke u bazuar në dështimin e Institucionit Financiar Raportues të Kosovës për të raportuar informacione mbi llogaritë e SHBA-ve që i nënshtrohen raportimit, siç specifikohet në nenin 4(1)(a) të IGA-së, ose për pagesat e 2015 dhe 2016 lidhur me institucionet jo-financiare, siç specifikohet në nenin 4 (1) (b) të IGA-së.

4.2.1.2 Dështimi për të bërë korrigjim me kohë: Dështimi i Institucionit Financiar të Raportimit për të korrigjuar gabimet administrative ose gabime tjera të vogla mund, në diskrecionin e Autoritetit Kompetent të SHBA-ve, të çojë në konstatim të mospërputhshmërisë së konsiderueshme. Megjithatë, Autoritetet Kompetente presin që në rrjedhën e zakonshme, konstatimi i mospërputhshmërisë së konsiderueshme nuk do të ndodhë së paku 120 ditë pasi njoftimi i specifikuar në Paragrafin 4.3.1 t'i ofrohet, dhe të pranohet nga, Autoriteti Kompetent i Kosovës (sipas paragrafit 3.3.4).

4.2.1.3 Mospërputhshmëri të tjera sipas IGA-së: Autoriteti Kompetent i SHBA-ve mund të konstatojë mospërputhshmëri të

konsiderueshme në lidhje me Institucionin Financiar Raportues të Kosovës deri në masën që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 4 të IGA-së, duke përfshirë dështimin për (i) të mbajtur në burim çfarëdo pagese burimore nga SHBA që janë subjekt i tatimit në burim, të bëra tek çfarëdo Institucioni jo-financiar, deri në masën që kërkohet në nenin 4 (1) (d) të IGA-së; (ii) t'i sigurojë paguesit të menjëhershëm të pagesës burimore nga SHBA që është subjekt i tatimit në burim, informata të kërkuara për mbajtjen në burim dhe raportimin e çdo pagese të tillë tek një Institucion jo-financiar, deri në masën e kërkuar në nenin 4(1)(e) të IGA-së; dhe (iii) tu pajtuar me nenin 4(5) të IGA-së në lidhje me entitetet e ndërlidhura dhe degët që janë Institucione jo-financiare. Mungesa e pajtueshmërisë me kushtet e tjera të përcaktuara në nenin 4, siç janë pajtueshmëria me kërkesat e aplikueshme për regjistrim, gjithashtu mund të çojë në konstatimin e mospërputhshmërisë së konsiderueshme në lidhje me Institucionin Financiar Raportues të Kosovës.

4.2.1.4 Konsultimi: Në rrjedhën e zakonshme, Autoritetet Kompetente parashikojnë konsultime përpara se të konstatojnë mospërputhshmëri të ndjeshme.

4.2.2 Gabimet administrative ose të tjera të vogla: Sipas nenit 5(2) të IGA-së, gabimet administrative dhe të tjera të vogla përfshijnë raportimin e pasaktë ose jo të plotë të informacionit të përshkruar në nenet 2(2) dhe 4(1)(b) të IGA-së ose gabime të tjera që rezultojnë në shkelje të IGA-së.

4.2.2.1 Ndryshimet e vetë-iniciuara të raportimit: Në rast se Autoriteti Kompetent i Kosovës merr njoftim nga Institucioni Financiar Raportues i Kosovës ose nga apo në emër të Institucionit Financiar të paragrafit 1.1.2 në lidhje me ndonjë lëshim ose gabim tjetër në ndonjë raport të shkëmbyer, raporti duhet të ndryshohet. Autoriteti Kompetent i Kosovës duhet t'i dërgojë çdo raport të ndryshuar Autoritetit Kompetent të SHBA-ve, sa më shpejt që të jetë e mundur.

4.3 Procedurat e njoftimit: Sa i përket adresimit të mospërputhshmërisë, Autoriteti Kompetent i SHBA-ve njofton Autoritetin Kompetent të Kosovës në pajtim me nenin 5 të IGA-së. Procedurat e njoftimit do të ndryshojnë në varësi të faktit nëse Autoriteti Kompetent i SHBA-ve kërkon të adresojë gabime të tjera administrative ose mospërputhje të ndjeshme.

4.3.1 Procedurat për gabimet administrative ose të tjera të vogla: Siç parashikohet në nenin 5 (2) të IGA-së, Autoriteti Kompetent i SHBA-ve do të njoftojë Autoritetin Kompetent të Kosovës kur Autoriteti Kompetent i SHBA-ve ka bazë për të besuar se gabimet administrative ose ato tjera të vogla mund të kenë çuar në raportim të pasaktë ose jo të plotë të informacionit ose rezultojnë në shkelje të tjera të IGA-së. Më pas,

Autoriteti Kompetent i Kosovës zbaton ligjin e tij të brendshëm (përfshirë dënimet në fuqi) për të marrë informacione të plota dhe të sakta, ose për të zgjidhur shkeljet administrative apo të tjera të vogla të IGA-së dhe të shkëmbejë informacione të tilla me Autoritetin Kompetent të SHBA-ve.

4.3.2 Procedurat për mospërputhshmëritë e ndjeshme:

4.3.2.1 Në përgjithësi: Sipas nenit 5(3) të IGA-së, Autoriteti Kompetent i SHBA-ve njofton Autoritetin Kompetent të Kosovës kur Autoriteti Kompetent i SHBA-ve ka konstatuar se ekziston mospërputhshmëri e konsiderueshme me detyrimet në lidhje me institucionin Financiar Raportues të Kosovës. Pas njoftimit të tillë për mospërputhshmëri të ndjeshme nga ana e Autoritetit Kompetent të SHBA-ve, Autoriteti Kompetent i Kosovës zbaton ligjet e brendshme të saj (përfshirë dënimet në fuqi), për të adresuar mospërputhshmërinë e konsiderueshme të përshkruar në njoftim. Autoritetet Kompetente mund të këshillohen për hapat e nevojshëm për të adresuar një mospërputhshmëri të tillë. Nëse Autoriteti Kompetent i SHBA-ve do të njoftonte Autoritetin Kompetent të Kosovës për konstatimin e mospërputhshmërisë së ndjeshme, data e dhënies së njoftimit për, dhe pranimit nga, Autoriteti Kompetent i Kosovës (sipas paragrafi 3.3.4) do të përbënte fillimin e periudhës 18 mujore të përcaktuar në nenin 5 (3) (b) të IGA-së.

4.3.2.2 Njoftimi tek Institucioni Financiar Raportues i Kosovës: Autoriteti Kompetent i Kosovës duhet të njoftojë Institucionin relevant Financiar Raportues të Kosovës lidhur me konstatimin e mospërputhshmërisë së konsiderueshme, përfshirë datën kur Autoriteti Kompetent i SHBA-ve ka njoftuar Autoritetin Kompetent të Kosovës për mospërputhshmërinë e tillë (sipas Paragrafit 3.3.4). Njoftimi gjithashtu duhet të tregojë se nëse mospërputhshmëria e ndjeshme nuk korrigjohet brenda 18 muajve nga data kur Autoriteti Kompetent i SHBA-ve i ka dhënë njoftimin Autoritetit Kompetent të Kosovës, institucioni Financiar Raportues i Kosovës mund të trajtohet si Institucion jo-financiar, dhe emri i tij mund të hiqet nga lista IRS FFI, dhe rrjedhimisht mund t'i nënshtrohet mbajtjes në burim prej 30 për qind sipas nenit 1471(a) të Kodit të të Ardhurave të Brendshme të SHBA-ve.

4.4 Periudha e Tranzicionit për Rregullimin dhe Zbatimin:

4.4.1 Autoritetet Kompetente synojnë që vitet kalendarike 2014 dhe 2015 të jenë periudhë tranzicioni për qëllime të zbatimit dhe administrimit të çdo mbledhjeje të të dhënave, kujdesi të duhur, raportim të informacionit, shkëmbim automatik të informacionit dhe kërkesë të mbajtjes në burim të përshkruar në IGA. Autoriteti Kompetent i SHBA-ve ka për qëllim të marrë parasysh përpjekjet për mirëbesim të Autoritetit Kompetent të

Kosovës, Institucioneve Financiare Raportuese të Kosovës, dhe Institucioneve Financiare të paragrafit 1.1.2 në drejtim të pajtueshmërisë me kërkesat e tilla gjatë kësaj periudhe tranzicioni kur tentohet zbatimi.

- 4.4.2 Periudha e tranzicionit, e përshkruar në paragrafin 4.4.1 mund të zgjatet nga Autoriteti Kompetent i SHBA-ve pas konsultimit me Autoritetin Kompetent të Kosovës.

- 4.5 Pyetje të përgjithshme: 4.4 Sipas nenit 5(1) të IGA-së, Autoriteti Kompetent i SHBA-ve ka për synim t'i bëjë kërkesa pasuese Autoritetit Kompetent të Kosovës, të cilat përshkruhen në nenin 5(1) të IGA-së ("Kërkesat e Autoritetit Kompetent"). Si përgjigje, Autoriteti Kompetent i Kosovës synon t'i marrë informatat e kërkuara shtesë nga Institucionet Financiare Raportuese të Kosovës në lidhje me Llogaritë e SHBA-së të cilat i nënshtrohen raportimit dhe më pastaj t'ia ofrojë këto informata shtesë Autoritetit Kompetent të SHBA-ve.
- 4.5.1 Autoriteti Kompetent: Shkëmbimi i informatave në lidhje me Kërkesat e Autoritetit Kompetent pritet të bëhet midis Autoriteteve Kompetente ose përfaqësuesve të tyre të autorizuar. Autoritetet Kompetente synojnë ta njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim duke ofruar informata kontaktuese (emrin, titullin dhe adresën e postës) për Autoritetin Kompetent të secilit juridiksion për qëllime të IGA-së si dhe t'i përditësojnë këto informata kontaktuese, sipas nevojës.
- 4.5.2 Përmbajtja e Kërkesave: Kërkesa e Autoritetit Kompetent, në përgjithësi, duhet të përmbajë informata të mjaftueshme të historikut për ta komunikuar si rëndësinë e kërkesës për ekzaminim, hetim, ose procedurë ashtu edhe natyrën e informatave që po kërkohen. Kërkesa e Autoritetit Kompetent duhet të përmbajë informata identifikuese në lidhje me personin individual ose grupin e personave (zakonisht emrin, adresën, dhe/ose TIN), periudhat e tatueshme për të cilat kërkohen informata, përshkrim të hollësishëm të informatave specifike të kërkuara, p.sh., dokumentet për hapjen e llogarisë, kartat e nënshkrimeve, pasqyrat e llogarive, kopjet e çeqeve të anuluar, fletë-depozitat, transferet elektronike, si dhe emrin dhe GIIN-in e Institucionit Financiar Raportues të Kosovës që besohet se i posedon informatat e kërkuara. Për shembujt e informatave shtesë të cilat mund të përfshihen në Kërkesën e Autoritetit Kompetent, shih Shtojcën 2 të Forumit Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informatave për Qëllimet e Taksave *Manuali i Punës për Shkëmbim të Informatave* ("Manuali i Punës së EOI"), i cili aktualisht gjendet në <http://www.oecd.org/tax/transparency/EOI%20manual.pdf>, dhe publikimet ekuivalente pasuese.
- 4.5.3 Procedurat për kërkesa: Autoriteti Kompetent i Kosovës duhet ta konfirmojë pranimin e Kërkesës nga Autoriteti Kompetent brenda dhjetë ditëve nga data e pranimit. Autoriteti Kompetent i Kosovës duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat relevante për mbledhjen e informatave të cilat lejohen në bazë të ligjeve të tij të brendshme, për t'i siguruar Autoritetit Kompetent të SHBA-së informatat e kërkuara, pavarësisht faktit që Kosova mund të mos ketë nevojë për informata të tilla për qëllimet e veta tatimore. Në rast se Kërkesa e Autoritetit Kompetent kërkon vërtetimin e kopjeve të regjistrave origjinalë, siç është certifikata e vërtetimit e ekzekutuar nga mbajtësi i regjistrave, Kosova duhet t'i marrë dhe t'i shkëmbejë këto kopje të vërtetuara deri në atë masë sa ligji ose praktika administrative e saj e lejon.

- 4.5.4 Afati kohor për t'u përgjigjur: Autoriteti Kompetent i SHBA-ve pret nga Autoriteti Kompetent i Kosovës që t'i sigurojë atij informatat shtesë të kërkuara, brenda 90 ditëve pasi Autoriteti Kompetent i Kosovës ta pranojë Kërkesën e Autoritetit Kompetent.
- 4.5.5 Pamundësia për t'u përgjigjur: Në rast se Autoriteti Kompetent i Kosovës nuk është në gjendje të sigurojë përgjigje të plotë brenda afatit kohor të përkthyer në Paragrafin 4.5.4, Autoriteti Kompetent i Kosovës duhet të sigurojë përgjigje të pjesshme, për aq sa është e mundur, dhe përditësim lidhur me statusin e informatave të mbetura të kërkuara. Në rast se Autoriteti Kompetent i Kosovës nuk është në gjendje t'i sigurojë informatat e kërkuara si përgjigje ndaj Kërkesës së Autoritetit Kompetent, ai duhet ta informojë menjëherë Autoritetin Kompetent të SHBA-ve dhe t'i shpjegojë arsyet e pamundësisë së tij për t'i siguruar informatat e kërkuara.

Paragrafi 5

MBROJTJA E KONFIDENCIALITETIT

- 5.1 Konfidencialiteti dhe përdorimi: Në përputhje me nenin 3(7) të IGA-së, të gjitha informatat e shkëmbyera në përputhje me IGA-në i nënshtrohen konfidencialitetit dhe mbrojtjeve të tjera të parashikuara në nenin 9 të IGA-së ("Mbrojtja e Konfidencialitetit"), duke përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informatave të shkëmbyera. Autoritetet Kompetente synojnë t'i zbatojnë ose të vazhdojnë t'i praktikojnë, sipas nevojës, politikat dhe praktikat administrative për ta mbrojtur konfidencialitetin e informatave të shkëmbyera, në përputhje me Udhëzuesin e Forumit Global të OECD-së *Keeping it Safe* të vitit 2012, i cili aktualisht gjendet në <http://www.oecd.org/tax/transparency/final%20Keeping%20it%20Safe%20with%20cover.pdf>.
- 5.2 Rreziku i Transmetimit dhe Përgjegjësia për Informatat e Transmetuara përmes IDES: Autoriteti kompetent i SHBA-ve synon të sigurojë Mbrojtjen e Konfidencialitetit në lidhje me informatat e transmetuara përmes IDES nga momenti kur informatat ngarkohen me sukses në IDES. Kur Autoriteti Kompetent i Kosovës zgjedh ta përdorë IDES si mjet për mbledhjen e të dhënave M1O2, Autoriteti Kompetent i Kosovës synon ta sigurojë Mbrojtjen e Konfidencialitetit nga momenti kur informatat ngarkohen me sukses nga Institucioni Financiar Raportues i Kosovës ose nga ana e apo në emër të Institucionit Financiar të specifikuar në Paragrafin 1.1.2 tek IDES. *Shih* Manualin e Përdoruesit të FATCA IDES (Publikimi IRS 5190). Autoriteti Kompetent i Kosovës synon ta sigurojë Mbrojtjen e Konfidencialitetit në lidhje me informatat e transmetuara nga Autoriteti Kompetent i SHBA-së përmes IDES nga momenti kur i shkarkon me sukses informatat e tilla nga IDES.

- 5.3 Njoftimi për Shkelje Ekzistuese ose të Mundshme të Konfidencialitetit dhe Masat Mbrojtëse: Autoriteti Kompetent duhet ta njoftojë Autoritetin tjetër Kompetent menjëherë në lidhje me ndonjë shkelje ekzistuese ose të mundshme të Mbrojtjes së Konfidencialitetit.

Paragrafi 6

SHPENZIMET

- 6.1 Çdo Autoritet Kompetent synon t'i mbulojë shpenzimet e veta të bëra gjatë administrimit të IGA-së dhe kësaj Marrëveshjeje. Autoriteti Kompetent i Kosovës synon t'i mbulojë shpenzimet e veta në zbatimin e ligjeve të veta të brendshme dhe ofrimin e ndihmës në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Autoritetet Kompetente mund të konsultohen me njëra-tjetrën para se të bëjnë shpenzime të jashtëzakonshme për të shqyrtuar nëse duhet të alokohen shpenzimet e tilla ndërmjet Autoriteteve Kompetente, dhe në raste kur duhet bërë diçka të tillë, për të shqyrtuar se si duhet bërë alokimi.

Paragrafi 7

HYRJA NË FUQI, KONSULTIMI DHE MODIFIKIMI

- 7.1 Data e Hyrjes në Fuqi: Kjo Marrëveshje hyn në fuqi më së voni (i) në datën kur IGA hyn në fuqi, ose (ii) në datën kur Marrëveshja nënshkruhet nga ana e Autoritetit Kompetent të SHBA-ve dhe atij të Kosovës. Posa Marrëveshja të hyjë në fuqi, dispozitat e saj zbatohen për të gjitha informatat që shkëmbehen në përputhje me IGA-në, përfshirë informatat për vitet kalendarike që i paraprijnë datës së hyrjes në fuqi.
- 7.2 Konsultimi: Çdo Autoritet Kompetent mund të kërkojë në çdo kohë konsultime lidhur me zbatimin, interpretimin, aplikimin ose modifikimin e kësaj Marrëveshjeje. Konsultimi i tillë (përmes diskutimit ose korrespondencës) duhet të bëhet brenda periudhës prej 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës së tillë, përveç në rastet kur vendoset ndryshe me dakordim reciprok. Nëse Autoriteti Kompetent i Palës beson se Pala tjetër nuk i ka përmbushur detyrimet e saja nën IGA, ajo mund të kërkojë konsultim të menjëhershme për ta siguruar përmbushjen e IGA-së.
- 7.3 Modifikimi: Kjo Marrëveshje mund të modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë të Autoriteteve Kompetente, me shkrim.
- 7.4 Shkëputja: Kjo Marrëveshje ka për qëllim të shkëputet automatikisht pas përfundimit të IGA-së. Në rast të shkëputjes, të gjitha informatat e marra më herët sipas kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen Mbrojtjes së Konfidencialitetit.

Paragrafi 8

Publikimi

Autoritetet Kompetente synojnë ta vënë këtë Marrëveshje në dispozicion të publikut përmes publikimit zyrtar nga secila Palë brenda 30 ditëve nga data e fundit e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje. Autoritetet Kompetente presin që ta përcaktojnë datën dhe kohën e saktë përmes konsultimit.

Për Autoritetin Kompetent të Shteteve të Bashkuara të Amerikës:

Për Autoritetin Kompetent të Kosovës:

Douglas W. O'Donnell

Sakip Imeri

Komisioner, Divizioni i Bizneseve të Mëdha dhe Bizneseve Ndërkombëtare, Shërbimi i të Hyrave të Brendshme

Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës

Data

Data